



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1577/1 Prot

Tiranë, më 08.11.2019

V E N D I M

Nr.124, datë 08.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Kurbin , të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Kurbin,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65 (nr. 1453 prot), datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Kurbin.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim.

Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Këshilli i Bashkisë Kurbin për kryerjen e funksioneve administrative të institucionit, me vendimin nr. 173, datë 12.12.2018, *“Për miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin, njësave dhe institucioneve në varësi”*, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Kurbin dhe institucioneve në varësi për vitin 2019.

Në zbatim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Kurbin, bazuar në nenin 64, shkronja “j”, të ligjit nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, ka nxjerrë urdhrin nr. 18, datë 11.1.2019 *“Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kurbin, institucioneve dhe agjencive në varësi dhe klasat e pagave për nëpunësit civil në bashki dhe njësitë administrative për vitin 2019”*. Kjo është struktura në fuqi, në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Kurbin ka **59** punonjës, të punësuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji për nëpunësin civil ku, **1** punonjës është i punësuar në pozicion të kategorisë së lartë drejtuese (*sekretar i përgjithshëm*), **8** punonjës janë të punësuar në pozicione të kategorisë së mesme drejtuese (*drejtor drejtorie*), **10** punonjës janë të punësuar në pozicione të kategorisë së ulët drejtuese (*përgjegjës sektori*) dhe **40** punonjës janë të punësuar në pozicione të kategorisë ekzekutive. Nëpunësit civil të punësuar në pozicione të kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese zotërojnë diplomë të nivelit master shkencor.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se, të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil të zëna (**59**), janë plotësuar nga punonjës të emëruar rregullisht, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ndërsa **2** pozicione pune të shërbimit civil, rezultuan vende të lira.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të përmbillet procesi i inspektimit të kryer në Bashkinë Kurbin, pasi nuk janë evidentuar parregullsi gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil nga ana e njësisë

përgjegjëse dhe e subjekteve të tjera të ngarkuara me detyra të veçanta për administrimin e shërbimit civil, në këtë institucion.

2. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Kurbin, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Kurbin, si dhe Ministria e Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha